

Ky dokument nuk është prova. Prova janë bajtët e ruajtur: HTML-ja e faqes, pamja e saj, dhe zinxhiri i hash-eve që i lidh. Kjo dëshmi është paraqitja e tyre, e prodhuar automatikisht. Verifikohet me kodin më poshtë **pa na pyetur ne**.

ARTIKULLI

TITULLI	Rrogat e magjistratëve do rriten 8500 lekë, Komisioni i Ekonomisë miraton në parim draftin e PS
ADRESA	https://dosja.al/draft/miratohet-ne-parim-rritja-e-pagave-per-gjyqtaret-komisioni-i-ekonomise-kal-i514102
BURIMI	dosja.al
GJENDJA	edited

KOHË


KAPUR NGA NE	14 shtator 2026, 14:57:13 UTC <i>Dritarja jonë e pasigurisë: ± 900 s — intervali me të cilin e kontrollojmë këtë burim.</i>
DEKLARUAR NGA PORTALI	14 shtator 2026, 14:40:00 UTC <i>Koha e deklaruar vjen nga pala që po vlerësohet. Ora jonë nuk preket prej saj, dhe të dyja shfaqen këtu të ndara.</i>

HASH-ET · SHA-256

PËRMBAJTJA	928f97fc9e4f072d8a9bb6e94cb4a5bffa07852d4987e760ee9b7e014c0390a
TEKSTI	66f612dff5e362a85dad8d8556998cbdf1806cb52d0cdf1d04c1dfcde1b28b4b
PAMJA	451118cef347bdbc5ba246bf714d2c4509766fb89eb6527d6c1d9f54a2a2d7a8

ZINXHIRI I PROVËS

KJO HYRJE	4748918173beb987a5236a48b657124f4d78fb2ca6ef2896626089187dec096e
E MËPARSHMJA	680895a265ff2b92a45ec1f1bc6bd8356e1071fdf32072a54341a1f9337265ff
RRËNJA MERKLE	c5c495e1993bed01ae9e3c22701c0f0e7f56228ef65729414d07abae87f787
ANKORIMI	submitted — dërguar, ende pa bllok <i>Deri te blloku, kjo provon integritetin, jo kohën.</i>



SKANOJE PËR TA VERIFIKUAR

Kodi të nxjerr te eksploruesi i STAMLES. Ai regjistër nuk është yni: nëse serveri ynë bie nesër, vula mbetet aty ku është.

Faqja tregon njërën nga tri gjendjet — **nuk u gjet**, **në radhë**, ose **e konfirmuar** me bllokun, rrënjën Merkle dhe transaksionin në Polygon. Krahazo hash-in që gjen atje me atë të shtypur më lart: nëse përputhen, kjo kapje ekzistonte para asaj ore, dhe ne nuk mund ta kishim ndryshuar pas saj.

https://scan.stamles.eu/verify/4748918173beb987a5236a48b657124f4d78fb2ca6ef2896626089187dec096e

PAMJA E FAQES

Renderuar nga HTML-ja jonë e ruajtur, jo nga rrjeti. **Riprodhon kopjen tonë, jo pamjen e atëhershme:** stilet dhe imazhet e largëta mund të mos ekzistojnë më ose të kenë ndryshuar.

Motori: chromium-stored+assets · dritarja 1280×1024 px



LIVE UPDATES ▾

2 ORE ME PARE

"Në epigëndër të takimeve ishte narkoshteti"/ Berisha pas kthimit në SHBA: Trump denoncoi rrezikun komunist dhe rrezikun e drogës, mbi të cilat qëndron regjimi i Ramës!

6 ORE ME PARE

Protestë te Zogu i Zi/ Shoqërohen 10 qytetarë nga policia, disa prej tyre dhunohen me grushta

6 ORE ME PARE

Nis viti i ri shkollor në sistemin parauniversitar / Rënie e numri të nxënësve, trafik i rënduar dhe alarm i rremë për bombë

22 ORE ME PARE

Dita e 106-të e protestës/ Qytetarët zbresin sërish në shesh, kërkohet dorëheqja e kryeministrit Rama: Ju erdhi fundi!

Aktualitet

Rrogat e magistratëve do rriten 8500 lekë, Komisioni i Ekonomisë miraton në parim draftin e PS

Kriza e pagave në sistemin e drejtësisë u përshkallëzua pasi Kuvendi nuk miratoi deri më 31 korrik formulën e re të pagave, në përputhje me kërkesën e Gjykatës Kushtetuese.



14 Shtator 2026, 16:40
Nga E. D



Komisioni i Ekonomisë

editoriale

Irena Beqiraj

Fashizmi nuk duhet
kërkuar tek revolta e
protestuesve por në Kuvend!

Meri Lika

Plaçkaxhiu

Në vëmendje

TIRANË- Komisioni i Ekonomisë miratoi në parim draftin e mazhorancës për pagat e magistratëve. Drafti u miratua me 8 vota pro, 2 kundër dhe 1 abstenim. Mazhoranca vijon të mbështesë propozimin për rritjen e pagës referuese të magistratëve nga 36% në 38% të pagës së Presidentit të Republikës. Sipas draftit, kjo rritje përkthehet në rreth 8,500 lekë më shumë në pagën referuese të magistratëve.

Shifra është dukshëm më e ulët se kërkesa e Këshillit të Lartë Gjyqësor (KLGJ) dhe Këshillit të Lartë të Prokurorisë (KLP), të cilët kanë kërkuar një rritje prej rreth 80 mijë lekësh. Gjatë mbledhjes së Komisionit, deputetët socialistë thanë se formula e propozuar respekton vendimin e Gjykatës Kushtetuese, si dhe mundësitë financiare të shtetit.

Deputetja e Partisë Socialiste, Aulona Bylykbashi, e cila është propozuesja e draftit për ndryshimin e pagave të magistratëve, tha se Gjykata nuk ka imponuar një formulë të vetme numerike për përcaktimin e pagave, por sipas saj, ia ka lënë ligjvënësit zgjedhjen e modelit, me kusht që të respektohen standardet kushtetuese.

"E rëndësishme se gjykata nuk ka imponuar një formulë të vetme numerike zgjedhja e modelit është tërësisht në diskrecionin e ligjvënësit me kusht që të respektojë standardet kushtetuese. Ndryshimi i parë paga referuese bazë. Në nenin 1 propozojmë që koeficienti i pagës të kalojë nga 0.36-0.38% të pagës së Presidentit të Republikës. Koeficienti 0.38% shifër si rezultat i një vlerësimi. Paga nuk është e izoluar paga bruto përfshin përkatësinë në grup, vjetërsinë", tha Bylykbashi.

Ndërkohë, deputeti i Partisë Socialiste, Erion Braçe, kritikoi ashpër KLGJ dhe KLP për vendimet për pagat e magistratëve. Ai tha se KLGJ dhe KLP duhet të kërkojnë falje, pasi sipas tij, morën kompetenat e Kuvendit. Socialisti tha më tej se vendimi i tyre përbën një akt që mund të kallëzohet, ndërkohë shtoi se pasi Kuvendi të kërkojë ndjesë që nuk zbatoi vendimin brenda afatit të 31 korrikut, duhet t'i kallëzojë.

"Ata të KLP dhe KLGJ t'i kërkonin ndjesë minimalisht deputetëve të këtij komisioni. Në ka atributet kushtetuese në"

AKTUALITET 14 SHTATOR 2026, 15:41

"Mbaje mend do të vras"/
Kërcënohet me vdekje
gazetari Osman Stafa, Policia:
Materialet u referuan në
Prokurori për 3 vepra penale

POLITIKE 14 SHTATOR 2026, 14:44

A do mbushet bregdeti i
Semanit me parqe foto
voltaike? Subashi i Fierit hap
5 tendera për dhënie me qira
të 391 mijë m2 tokë

përcaktimin e rrogave të tyre. Vendimi i tyre, jo vetëm që nuk ka pyetur për këtë, por ka marrë kompetenca të drejtpërdrejta të Kuvendit të Shqipërisë. Gjykata Kushtetuese i kërkoi parlamentit t'ia përcaktonte rrogën. Ai akti që ata kanë bërë është edhe akt i kallëzueshëm. Kallëzimi që ata kanë bërë për drejtuesit e thesarit të Shqipërisë është i paprecedentë, akt vetëgjyqësie i pandodhur në këtë vend. Ky Kuvend, pasi të kërkojë ndjesë pse nuk ka zbatuar vendimin para datës 31 korrik, t'i kallëzonte ata", tha Braçe.

Nga ana tjetër, përfaqësuesi i Ministrisë së Drejtësisë tha se koeficienti 0.38 plotëson kushtet e vendosura nga Gjykata Kushtetuese, ndërsa Ministria e Financave e konsideroi të përballueshme koston për buxhetin.

Ndërsa opozita e kundërshtoi draftin me argumentin se qeveria nuk po respekton vendimet e Kushtetueses. Sipas deputetit demokrat, Eno Bozdo, situata e krijuar me pagat është pasojë e mosrespektimit të vendimeve të Gjykatës Kushtetuese nga qeveria.

"Çdo gjë ka ndodhur si pasojë e mosrespektimit të disa herëve se qeveria nuk çan kokën për vendimet e Kushtetueses. Më habit fakti që edhe pse Kuvendi e ka deleguar nismën që në prill të këtij viti qeverisë dhe nisma s'vjen nga qeveria, po nga dy kolegë të nderuara. Këshilli i Legjislacionit i ka kërkuar qeverisë shqiptare të paraqesë projektligjin. Kemi këtu përfaqësuesin e Min. së Drejtësisë që është shumë i kënaqur. Na mungon fatura e plotë financiare, por ne nuk i kemi në projektrelacion këto shifra, pa to s'bëjmë dot", tha Bozdo.

Kritika pati edhe deputeti demokrat, Bujar Leskaj, i cilësoi si të paligjshme vendimet e KLGJ-së dhe KLP-së për pagat dhe tha se Kuvendi nuk duhet t'i "bëhet violinë" kryeministrit Edi Rama.

"KLGJ dhe KLP për mua janë në paligjshmëri me ato vendime, ne duhet të kërkojmë zbatimin e ligjeve të kushtetuese apo tu bëhemi violin e një kryeministri të papërgjegjshëm i cili e krijoi këtë situatë për shantazh ndaj sistemit të drejtësisë", deklaroi Leskaj.

Ngërçi me pagat në gjyqësor

Kriza e pagave në sistemin e drejtësisë u përshkallëzua pasi Kuvendi nuk miratoi deri më 31 korrik formulën e re të pagave, në përputhje me kërkesën e Gjykatës Kushtetuese. Pas skadimit të afatit, Këshilli i Lartë Gjyqësor (KLGJ) dhe Këshilli i Lartë i Prokurorisë (KLP) vendosën që, nga 1 gushti, paga referuese të llogaritej mbi bazën e 222 mijë e 425 lekëve, duke i shtuar edhe 14 mijë lekë për kualifikimin. Megjithatë, Ministria e Financave nuk i ekzekutoi listëpagesat sipas kësaj formule, me argumentin se përcaktimi i pagave të magjistratëve dhe administratës së drejtësisë është kompetencë e Kuvendit./Dosja.al

komisioni i ekonomisë

Sondazh

Poll

AKTUALITET 14 SHTATOR 2026, 10:49

SKANDAL/ Policia dhunon protestuesit, momenti kur efektiv i 'Shqiponjave' i gjuan me gusht në bark

më të klikuarat

Vajza e saj 10 muajshe ishte me temperaturë të lartë/ Gazetarja rrëfen eksperiencën në Pediatrinë e QSUT-së: Prindërit përballen me arrogancë dhe poshtërim

Tension te Zogu i Zi/ Protestuesit zhvillojnë tubim në ditën e parë të shkollës, shoqërohen disa prej tyre (VIDEO)

Takimet për Reformën Territoriale/ Rama në Berat: Çfarë lidhje ka distanca? Ndryshon vetëm drejtimi vendor

SKANDAL/ Policia dhunon protestuesit, momenti kur efektiv i 'Shqiponjave' i gjuan me gusht në bark

insights

Ola Xama
Republika e 1 euroshit ku Rama zgjedh kush bëhet biznesmen

Idriz Konjari
Sa gati është biznesi shqiptar për tu përshtatur me tregun e BE-së?

Bledian Koka
Pse Erion Veliaj e "shkarkoi" sot Edi Ramen?

Fjola Graçi
REPUBLIKA E TRUPROJAVE/ Nga tokat te klubet VIP: Rrjoll, Zvërnec, Sarandë e Ksamil nën hijen e "burrave të zinj"

Moti

Powered by tomorrow.

Aktualitet

14 Shtator 2026, 15:54

Kërcënimi ndaj gazetarit Osman Stafa/

Osman Stafa, gazetar i njohur në "Koha Ditore", është kërcënuar nga një person që pretendon të jetë...

SafeJournalist: Autoritetet ta netojne urgjensusht, te merren masat për sigurinë e tij

foto ilustruese TIRANË- SafeJournalist ka reaguuar pas kërcënimit me vdekje të gazetarit Osman Stafa. Rrjeti ka dënuar kërcë...

"Mbaje mend do të vras"/ Kërcënohet me vdekje gazetari Osman Stafa, Policia: Materialet u referuan në Prokurori për 3 vepra penale

Aktualitet
14 Shtator 2026, 15:41

Kontroll blic me urdhër të SPAK-ut në sektorin ku mbahet Ergys Agasi. Gjenden pajisje wireless dhe alkool!

Aktualitet
14 Shtator 2026, 14:53

Qëlloi në bark protestuesin e prangosur, pezullohet nga detyra efektiv

Aktualitet
14 Shtator 2026, 14:34

Aksident rrugor në aksin Fier – Mallakastër, plagosen tre persona

Aktualitet
14 Shtator 2026, 13:41

Aktualitet
14 Shtator 2026, 13:10

Viti i ri shkollor 2026-2027/ Mbyllet shkolla në Eçmenik të Devollit, kishte vetem dy nxënës

Shkolla DEVOLL- Viti i ri shkollor 2026-2027 është shoqëruar jo vetëm me ulje të numrit të nxënësve, por ...

**VIDEO/ Kapen 41 kg e 350 grame
kokainë në Portin e Durrësit nga Brazili.
Vlera në treg 2 milionë euro**

Aktualitet

14 Shtator 2026, 12:59

**Aksident i rëndë rrugor në Peqin/ Audi
përplas të moshuarin, 70-vjeçari ndërron
jetë rrugës për në spital**

Aktualitet

14 Shtator 2026, 12:03

**Theu urdhrin e mbrojtjes dhe plagosi me
drapër ish-vjehrrin, arrestohet daja i
Zegjine Çaushtit në Roskovec**

Aktualitet

14 Shtator 2026, 12:08

**Luxair sjell Luksemburgun përmes linjës
së re me Tirana International Airport**

Aktualitet

14 Shtator 2026, 12:00

MË SHUMË



**Braçe kritika të ashpra ndaj KLGJ dhe KLP për
vendimet për pagat: Të kërkojnë falje**



Braçe kritika të ashpra ndaj
KLGJ dhe KLP për vendimet
për pagat: Të kërkojnë falje



Berisha: Trump denoncoi
rezikun komunist dhe
rezikun e drogës, mbi të
cilat qëndron regjimi i
Ramës



Berisha: Në SHBA shprehëm
shqetësimin tonë për
përdorimin e drejtësisë si
armë politike nga Edi Rama



Berisha: Denoncuam farsën
elektorale, sekretari Rubio
nuk e uroi Ramën për
zgjedhjet!

[Shiko video te tjera](#)



KTHEHU NE KRYE

Dosja.al është një iniciativë gazetare e rinj dhe njerëzish të lirë, që nuk
ndikohet nga interesa politike apo biznesi. Informimi i paanshëm, qëndrimi i
pavarur dhe etika profesionale janë parimet tona. Ka media të majta, të djathta,
ke media të shqiptarë të shtetshëm, por ka edhe të shtetshëm, të bashkë

**AKTUALITET
POLITIKE**

Drejtor: Enton Abilekaj
Kryeredaktor: Izmir Akulli

na shprehim urrejtuesisht të gjithë ato shprehje, por na kërkim të përcaktuar, që marrin zgjedhur rrugën më të vështirë, por më të ndershme dhe më të sigurtë për të qenë të besueshëm. Dosja.ai do të jetë gjithmonë e pavarur, e vërtetë, në krah të interesit publik.

Telefon/Whatsapp: +355 68 2676 444
Email:



KONTAKT PRIVACY POLICY COOKIES

MEUNDISCAR NGJA Mediadesk

EKONOMI

BOTA

SPORT

ART&ARGËTIM

INSIGHTS

EDITORIAL

Gazetarë:

Esmeralda Doçi

Emanuela Dida

Elisa Karaj

Dorotea Simoni

Pamja këtu është e ri-koduar për ta futur në dokument. Artefakti autoritar është skedari WebP i ruajtur, dhe hash-i i tij është ai i shtypur te faqja e parë — pra dallimi është i verifikueshëm, jo i fshehur.